

Kalosh Çeliku

PRINC BIXHI

(Mikut t'im besnik: Bixhit. Që, u zhduk në rrethana misterioze).



Asdreni

Biblioteka
GUXO

Redaktor letrar
GANI XHAFOLLI

Redaktore gjuhësore
LAURA ÇUKA

Ballina dhe fotografitë:
FITORE DERALLA

Copyright by Asdreni

Kalosh Çeliku

PRINC BIXHI

(Mikut t'im besnik: Bixhit. Që, u zhduk në rrethana misterioze).



Asdreni

Shkup, 2007

Prolog

*Në lagjën tonë të madhe “Çair”
Lindi Princ Bixhi me diplomë.
Vërtet, është burrë asgan - Ilir
Nuk u shitë, jo: në Qafë Thanë.
E mori me dije e vlera të veta
O lumë miku: Tungjatjeta!*

*Prandaj, ky burrë me mustaqe
Meriton të hyjë në letërsi.
I ka veprat me qindra faqe
Herë pas here shkruan poezi.*

*E mbi të gjitha, është burrë mali
I veshur me armë deri në dhëmbë.
Lakmi ia ka, sot: Edhe gjenerali
Atdheun, jo ta shkelin me këmbë...*

1. DACI ZI NA ERDHI NË LËMË

Heret, ende pa ardhë dita
Dac Ziu me një çetë banditë
Trojeve tona iu sul në prita:
Princ Bixhin tonë me fletë
Zap ta bëj, t'i ndalet rrita.

Pusi trimit i vë te porta e Shtëpisë
Burri, me mustaqe vesh më vesh:
Pragu, armiqhtë s'i pret me torta
Pa u rrokur fyta, derdhë gjaqe.

Krisi pushka, seç u bë nami
Qyqja nënë, ku i lamë armët?!
Sot, na sulmoi Dac Ziu. Harami
Rrokni sëpatat, rrokni gërshërët!

Ballë më ballë i dalin në lëmë
Populli hanë barot me dhëmbë...



2. LUFTA KRISI BURRA PRANË NJË LISI

Tym e mjegull u mbush lëma
Krisi pushka, gjëmoi moti.
Dridhet toka, thyhen xhama
Vallë, u ngritë nga varri Kastrioti?!

“O bini armikut burrat e mejdanit
Këputni sumbullat e xhamadanit”!
Se, ky popull nuk do dhunë
Kush e sulmon, korrë furtunë.

E kemi zakon nga të parët
Para, dorzojmë jetën sesa, armët...



3. NDIHMË VIJNË DY BURRA E NJË GRUA

Lufta vazhdon. Dridhet “Çairi”
Tym e mjegull deri në qiell.
Ndihmë dy burra e një grua Iliri:
Pritni hasëm, nuk zihet Dielli!
Pa u farua fisi deri në djepa
Viteve ndezim zjarre në shkrepa.

E kemi zakon nga të parët
Mikun ta presim në shkallë.
Ndërsa, hasmin si shqiptarët
Me gërshërë e plumb në ballë.

O ikni komita se na turpëroi “Çairi”
Tre xhandarë na i vrau Cuca!
Barot me dhëmbë han Bixh Iliri...



4. PRINC BIXHI NË LËMË SHPALL FITOREN

Vrik e vrik u mbëlodh Katundi
Numrojnë humbjet, dhe fitoret.
Kulla jonë me Tri frengji:
Burra, sot: fytas luftoi për liri.
Për gjuhë amtare e shkolla
Ngriti lartë flamurin në molla.

Vit për vit do ta bëjmë namin
Kurrë nuk e shesim Vatanin...




5. DARKA MBRETËRORE SHTROHET NË LËMË

Dihet niveli, sipas çdo fundi
Darka shtrohet sipas zakonit:
Në dasëm thirret gjithë katundi
Mes kopshtit, nën hije të ftonit.

Burrat me mustaqe e armë në brez
Rreth sofrës, ulen sikur trima.
Majë gardhi këndon një këndez
Dikur, shti rrufeja, shkrep vetëtima.

Jo, trimat tanë s'e lënë sofrën
Këmbëkryq e presin, hanë troftën...



6. DARKËN PARA E PROVON PRINC BIXH MACI

Dhe, vjen trofta aristokrate
E ka përgaditur Dr. Daci:
Përsipri me limon e patate.
Jo, shkrintari thotë: I pari e provon
Darkën time: Princ Bixh Maci.

E nëse ky burrë e han me shije
Darka është përgaditur pa hile.
Po, nëse ky trim nuk e prek fare
Atëherë, unë duhet gjetur çare.

Princ Bixh Maci, i mori erë troftës
Këmbë, mbylli hundët, u sul portës.
Darka, sot nuk i vleka pesë pare:
Dr. Daci, s'di ç'është Darka Shqiptare.



7. DARKA MBRETËRORE QËNKA - KAKË

Princ Bixhi, edhe njëherë i mori erë
Ndalet. Nuk i sulet s'paska vlerë.
E mbulon me këmbë këtë darkë
Thotë si kaçak: Vërtetë është kakë.
Dhe, i sulet sallamës si burrat
Dr. Daci, nuk ka erë nga furrat...



8. Dr. DACI DESH PLASI NGA INATI

Kuzhinieri ynë, që fryhej si bibani
Për darka aristokrate e mbretërore.
Vrik e uli kokën, iku nën shtrat:
Vërtetë sot nuk më shkoi përdore.
Po, nesër: do tju bëj drekë Parisi
Jo, thanë burrat: Na mungon Misi.

Ti, e ke zanat ta përgadisësh miun
Bashkë ta ndash me Doktorziun...



9. DHE NË FUND BURRA KRISI SHAMATA

U tubuan trimat, shkencëtarët
Komandantët. Dhe, kryetarët.
Në tryezë erdhën edhe shkrimtarët.
Papritmas, krisi pushkë shamata:
Thanë: Mjaftë më me “doktorata”!...



II PRINC BIXHI: NUK IK
NGA ATDHEU

1. LIRIA FITOHET NË MALE

Vërtetë, erdha nga malet
Që, t'u sjellë një copë liri.
Nga shpina t'ua heq hallet
Po, jeta nuk qenka poezi.

U përpoqa, t'ua hjek samarin
Edhe, ky hiqet burrërisht vetë.
Ligjet e fushës ndryshojnë me malin
Shumë kalemxhi keni, e pak poetë.

Lapsin ta nxjerrin nga brezi
Fyt për fyt të rroken si burrat:
Rrugë t'i bëjnë maleve një çezi
Që, me vite zbret nga gurrat...



2. GJUHA SHQIPE NË PUSI

Gjuha shqipe, Gjuhë e Nanës
Ende, është si dje: në pusi.
Kufiri, në Qafë të Thanës:
Librin, e zhvesh, i vë kufi.

Xha Naimit, Sot ia heq struken
E kontrollon n'xhepa për libra.
I rrezikshëm, i thotë je për veten
E detyrojnë të hyjë nga Dibra.

Edhe nga Kosova e ndanë me kufi
Copë - copë ia bënë Atdheun.
Vallë, kësaj i thuakan sot Liri
Zap, e bënë edhe Skënderbeun.

I thanë: Fute shpatën më në brez
Lirinë, do të na e sjellin të tjerët.
Në ballë të çetës u pri një melez
Kokëmëkokë, politikë të mjerët.

3. ÇIZMET E MËSUESES E KANË HAPUR GOJËN

Përditë, në klasë e shoh mësuesen
Me të njëjtat tasha, të njëjtën çantë.
Ditë për ditë na e zhveshin Nusen
Frikë kam: Do e hanë me një kafshatë.

Çizmet e saj, Sot: Si të Lulit Vocërr
E kanë hapur gojën në libër këndimi.
Xhaxhi Migjen, edhe kjo motër Nesër:
Na trembë. E ka hapur gojën mjerimi.

Shtriga në klasë na hyri me fshisë
Edhe atë, pa libra këndimi e fletore.
Dituria sa mundet, ende nga ne ikë
Pritë, kot i kemi vënë dorë për dore...



4. LEKTURAT SHKOLLORE I SHOHIM ĔNDĔRR

Nuk kemi shkolla, nuk kemi libra
Mësuesen na e morën nga klasa.
Hajredin Pasha na vjen nga Dibra
Hapni, o burra këto dyer se plasa!

Dritaret me hekura, matanë malit
Tymemjegull, si Muji t'i hip kalit!...



5. REVISTAT PËR FËMIJË I KEMI ME ARNA

Ku mbeti “Pionieri”, dhe “Gëzimi”
“Fatosi” , i Xhaxhit flokbardhë:
Edhe Sot, si Dje: Të na dalin zot?!
Vallë, a na dëgjon Xha Naimi
Vjershën e tij, të na i fshij këta lotë?!

Po, “Fatosi” me xhaxhin flokëbardhë
Ku humbi ai shok, ku na iku?!
Pse, nuk i hip prapë kalit bardhë
Nuk e sheh se na kërcnohet rreziku?!

Ballë për ballë na ka lënë kërcu
Me Hutin me veshë, që bën: Hu...



6. HORRAT NA LANË ME LOPËT

Nuk i shihni librat, planprogramet
Vjershat e tyre “artistike” sakate.
Poetët e Oborrit me namet partiake
Çirren, turren posteve si zogjë nate.

Çafkëzezat, kur na vijnë në shkollë
I përplasnin fletët mbi banka. Libra.
Bilbilin, e kanë përzënë në mollë
I thanë: Kënga yte është për plaka.

Ne, Sot: ia dimë rendin trimërisë
Nesër, zingjirët ia heqim Lirisë...




7. DHE PRINC BIXHI NUK IK NGA ATDHEU

E kotë, tha: Është Princ Bixhi
Luftë të bësh me këta horra:
Në një shtet, ku nuk jeton ligji
Arsimi dhe kultura. Libri. Kur,
Fabrikat përditë prodhojnë çorra.

Mësuesen, e trembin në klasë
Librin ta sakatojnë me sëpatë.
Edhe shkumës s'ke në dërrasë
E këndej, hiqen si demokratë.

Rrugë tjetër s'kemi, o burra
Mes këtij bërlloku që shpërtheu.
Këngën, këtu e ka ndalë gurra
Jo! Kurrë nuk ikë nga Atdheu.

Ehu, i kam malet, i kam fushat
Qafë për qafe do flej me arushat...



Shënime për autorin

Kalosh Çeliku lindi më 13 shkurt 1951 në fshatin Cërvicë të Kërçovës (IRJ e Maqedonisë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Shkollën e mesme normale në Shkup, ndërsa studimet e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Prishtinës (Kosovë). Çeliku shkruan poezi e prozë për fëmijë e të rritur dhe gjer më sot ka botuar rreth dyzetë libra: *Zogu erdhi me një këngë* - vjersha (1982), *Lepuri me pushkë* - tregime (1983), *Shtëpiza e xixëllonjave* - tregime (1984), *Ferexhja e zezë* - dramë (1985), *Arusha pa bisht* - tregime (1986), *Dielli zbret maleve* - novelë (1986), *Varrimi i sorrave* - roman (1988), *Vite me borë* - roman (1990), *Trumbetat e Tellallit* - satira (1992), *Imzot, lehin qentë* - drama (1993), *Trimi shihet në vepër* - poemë (1994), *Çohuni trima shaloni lapsin* - rrëfenja (1994), *Sorraku i Qytetit* - pjesë teatrore (1994), *Kali i Trojës nëpër Bit - Pazar* - satira (1994), *Loja e syve* - poezi (1995), *Babi ka dy nuse* - roman, (1995), *Vjellja e zorrëve* - poezi (1996), *Qyteti i qyqeve* - roman (1997), *E përçolla Natën* - poezi (1998), *Mbrëmë fjeta me Vjeshtën* - poezi (1999), *Kopeja me zgjebe ndjek Autorin* - drama (2000), *Shtëpia publike* - roman (2000), *Si u ndava me*

Gruan time“ - satira (2001), *Gratë e mia besnike* - roman (2001), *Lamtumirë bërllok* - nëntë drama (2002, 2007), *Me tre varre* - roman (2002), *Vdekja më deshi më pak se Ti* - poezi (2003), *Edhe Ajo nuk ishte xheloze* - poezi (2004), *Repriza e vëllazërim - bashkimit* - dramë (2005), *Atdheu ky burrë pa Grua* - poezi (2006), *Kulturofagu* - antiroman (2006), *Burrat i përzë me burra e Mua me gra* - poezi (2007), *Engjëlli im është Grua* - poezi (2007), *Dimri, s’vjen me lule* - 5 poema (2007), *Ujku e di një lojë* - poezi (2007), *Kur bërtet “vojvoda“ e pjell Kurvë Partia* - satira (2008), *Dac Poeti i shkruan poezi Mamit* - poemë humoristike (2008), *Ehu* - poezi (2008), *Gruaja besnike* - roman (2009), *Djemnusha* - roman (2010), *Atdheu burrë pa Grua* - poezi (përzgjedhje, 2010), *Xhadia* - publicistikë letrare (2011), *Cuca Boheme u jep gjì poezive të mia* - poezi, përzgjedhje në gjuhën gjermane (2012), *Plaga e dhjetë e Babait* - roman (2012), *Rrufjani* - publicistikë letrare (2012), *Qengji më tha ha bar* – roman (2013), *Plaga e dhjetë me Hënën* - poezi, përzgjedhje në gjuhën greke (2013), *Gruaverë* - përzgjedhje, poezi (2013) *Imzot, lehin qentë* – dhjetë drama (2013) *Këshjtjella e dashurisë* - poezi, përzgjedhje në gjuhën rumune (2015) etj. Që nga viti 1992 ai drejton Shtëpinë Gazetare - Botuese ASDRENI, në Shkup dhe është kryeredaktor i të vetmes revistë për humor dhe satirë **ZEKTHI**, që del kur t’i teket në IRJ

të Maqedonisë. Dhe, që nga viti (2009) mbarëkombëtarë si revistë për humor dhe satirë.

Kalosh Çeliku është fitues i disa çmimeve të konkurseve letrare në poezi, tregime dhe pjesë teatrore. Njëherit, edhe i çmimeve letrare: PERENDESHË E BUKURISË, në Netët e Poezisë Korçare (2003), në Korçë, Çmimin AS për letërsi (2007), në Kërçovë, “SYRI I KALTËR“ (2007), në Sarandë, “SEREMBE“ (2008), në Laç, “FLAKADANI I KARADAKUT“ (2009), në Viti, Çmim special për vëllimin poetik: EHU nga Simpoziumi Ndërkombtar “MUZA POETIKE”, “PEGASI” (2009), në Gjirokastër, “JEHONA E KARADAKUT” (2010), në Kumanovë, “SKAMPINI” në Festivalin Ballkanik të pozisë (2010), në Elabasan, Kurora e poezisë “KORÇA 2012”, në Korçë, Çmimin e parë për poezi të vitit (2014) “PAVARËSIA” e Kosovës nga Unioni i Shkrimtarëve dhe Kritikëve Shqiptar, në Prishtinë, METAFORA II (2014) nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Çmimin “Urat në vargun poetik” (2014) nga Klubi i Shkrimtarëve “Vorea Ujko”, në Klinë (Kosovë) etj.

Drama *Ferexhja e zezë* është vënë në skenë nga disa teatro në Kosovë e IRJ të Maqedonisë dhe është mirëpritur nga publiku e kritika letrare. Edhe satira *Ndihma e shpejtë* u përgatit për t’u vënë në skenë me mjaft sukses nga Trupa teatrore “Aleksandër Moisiu“ në Kumanovë dhe çoi

pluhur nëpër kuluaret e oborrtarëve. Drama tjetër *Zorra qorre* dy herë me radhë u përgatitë për skenë, një herë në Kumanovë dhe herën tjetër në Strugë, po i ranë në gjurmë kulturofagët dhe nuk u shfaq para publikut.

Një fat të këtillë kanë pasur edhe pjesët teatrale për fëmijë të shpërblyera me çmime letrare duke u luajtur në skenë dhe duke u emetuar përmes valëve të radiotelevizionit të Prishtinës (Kosovë) dhe Tiranës (Shqipëri).

Krijimtaria e tij letrare është përkthyer në disa gjuhë: maqedonase, gjermane, turke, bullgare, rumune, greke etj. Që nga viti 1992 – 1997, ishte nënkryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptar dhe kryetar 1997 – 2001. Momentalisht është kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë në IRJ të Maqedonisë. Dhe, themelues i disa manifestimeve kulturore tradicionale ndërkombëtarë: Ditët e Naimit, në Tetovë, Takime nën Rrap, në Shkup (poezi erotike) dhe i Ditëve të humorit dhe satirës: XHA DERALLA, në Kërçovë. Poashtu është edhe themelues dhe kryeredaktor i revistës letrare **STILI 97**, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar në IRJ të Maqedonisë.

Çeliku gjer më vitin 1995 punoi si mësues i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Drenicë të Kosovës dhe Malësinë e Shkupit. Vitet e fundit punon dhe jeton në Shkup, tashmë në profesionin e lirë të shkrimtarit.

Lufta vazhdon me penë...



Përmbajtja

Prolog / 4

1. Daci Zi na erdhi në lëmë / 5
2. Lufta krisi burra pranë një lisi / 6
3. Ndhimë vijnë dy burra e një grua / 7
4. Princ Bixhi në lëmë shpallë fitoren / 8
5. Darka mbretërore shtrohet në lëmë / 9
6. Darkën para e provon
Princ Bixh Maci / 10

7. Darka mbretërore qenka kakë / 11
 8. Dr. Daci plasi nga inati / 12
 9. Dhe në fund burra krisi shamata /13
 - II PRINC BIXHI: NUK IK NGA ATDHEU
 1. Liria fitohet në male / 14
 2. Gjuha shqipe në pusi / 15
 3. Çizmet e mësueses e kanë hapur
gojën / 16
 4. Lekturat shkollore i shohim ëndërr / 17
 5. Revistat për fëmijë i kemi
me arna / 18
 6. Horrat na lanë me lopët / 19
 7. Dhe Princ Bixhi: nuk ik
nga Atdheu / 20
Shënime për autorin / 21
-

Cip katologizimi në publikim Biblioteka popullore
dhe universitare « Sv. Kliment Ohridski », Shkup

821.18 (497.7) - 31

ÇELIKU, Kalosh

Princ Bixhi (Mikut t'im: Bixhit. Që, u zhduk në
rrethana misterioze) Kalosh Çeliku. - Shkup:
Asdreni. 2007. - 28 f.; 21 cm. - (Biblioteka:
GUXO)

ISBN 978-9989-174-35-3

COBISS.MK-ID 7591066

KALOSH ÇELIKU
PRINC BIXHI

Botues
ASDRENI

Korrektore
Fitore DERALLA

Formulimi kompjuterik
Ilir EMINI

Tirazhi: 5.00 kopje

U shtyp në shtypshkronjën:
Lena Graphic Design



DHE NË FUND BURRA KRISI SHAMATA

U tubuan trimat, shkencëtarët
Komandantët. Dhe, kryetarët.
Në tryezë erdhën dhe shkrimtarët.
Papritmas krisi pushkë shamata:
Thanë: Mjaftë më me “doktorata”!...

ISBN: 9989-174-35-3

Çmimi: 120 den./ 2 euro/ 150 lekë